



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:109720

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05662752

PKR.nr.78/2005

- GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i Trupit Gjykes Fatos Sejdiqaj, me zyrtarin ligjor Bardh Sylejmani, në çështjen penale ndaj të pandehurit I.Z. nga Skenderaji, për shkak të veprës penale-Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim, ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25 (tutje:KPPK), duke vendosur sipas aktakuzës së ish-Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.302/2004, të datës 24.02.2005, sipas detyrës zyrtare me datën 03.05.2024, mori këtë :

A K T V E N D I M

I.- HEDHET aktakuza e ish-Prokurorisë Publike të Qarkut, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.302/2004, të datës 24.02.2005, dhe **Pushohet** procedura penale kundër të pandehurit: **I.Z.**, nga i ati, dhe nëna, e vajzërisë, i lindur më datë, në fsh....., Komuna Skenderaj, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal, për veprën penale-Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim, ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPPK-së, **për shkak se i njëjti ka vdekur.**

II.- Në mbështetje të nenit 276 par.1 të KPP-së, URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i armës-pushkës së gjuetisë dy tytëshe, Cervana Zastava, me numër serik 175251. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, kjo armë duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, sipas procedurave ligjore në fuqi.

III.- Shpenzimet e procedurës penale mbulohen nga mjetet buxhetore të gjykatës.

IV.- Pala e dëmtuar A.(Rr.) I. nga fsh....., Komuna e Skenderajit, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

- Ish-Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur aktakuzën PP.nr.302/2004 me datë 24.02.2005, ndaj të pandehurit I.Z. nga Skenderaji, për shkak të veprës penale-Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim, ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPPK-së.
- Këtë lëndë penale Kryetari i Trupit Gjykses e ka pranuar me datën 19.01.2024 dhe pas pranimit të lëndës, nga Sistemi për Menagjimin Informativ të Lëndëve (SMIL) i cili është i ndërlidhur me Agjencinë e Regjistrimit Civil, Gjykata ka gjetur se statusi jetësor i të pandehurit evidentohet “i vdekur”.
- Lidhur me këtë, Gjykata me parashtrësë me shkrim të datës 26.02.2024 përmes komunikimit elektronik e-mailit zyrtar, i është drejtuar Komunës së Mitrovicës, përkatësisht zyrës së gjendjes civile, me kërkesën për vërtetimin e faktit të vdekjes për këtë të pandehur, nëse i njëjti ka vdekur dhe është i regjistruar.
- Me datë 27.02.2024, Komuna e Mitrovicës përmes e-mailit zyrtar pas verifikimit të të pandehurit, kanë njoftuar Gjykatën se i pandehuri I.Z. ka vdekur, duke i bashkangjitur certifikatën e vdekjes në emër të tij.
- Nga certifikata e vdekjes Nr.Ref..... dhe Nr.Rendor, e datës, lëshuar nga Zyrtarja e Gjendjes Civile Komuna e Mitrovicës, konstatohet se i pandehuri ka vdekur me datë nëMaqedoni.
- Gjykata, pasi që konstatoj se në rastin konkret i pandehuri ka vdekur, e duke u bazuar në nenin 357 par.1, nënpar.1.3 lidhur me nenin 158 par.1 të KPP-së, vendosi ta hedh aktakuzën dhe të pushoj procedurën penale për të pandehurin I.Z., të ngritur nga ana e ish-Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.302/2004 të datës 24.02.2005, akuzuar për veprën penale-Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim, ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPPK-së.
- Neni 357 par.1 i KPP-së përcakton se : *“Gjyqtari i vetëm gjykses ose Trupi vgjykses me aktvendim e hedh aktakuzën kur : nënpar.1.3 “ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen”*. Ndërsa, neni 158 par.1 i KPP-së ka përcaktuar se :*“Kur gjatë rrjedhës së procedurës penale vërtetohet se i*

pandehuri ka vdekur, varësisht nga faza e procedurës penale, prokurori i shtetit apo Gjykata merr aktvendim për pushimin e procedurës penale”.

- Gjykata vendosi si në pikën –II- të dispozitivit të këtij aktvendimi duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 276 par.1 të KPP-së, ashtu që ndaj të pandehurit urdhëroi konfiskimin e përhershëm të armës-pushkës së gjuetisë dy tytëshe, Cervana Zastava, me numër serik 175251, e cila armë pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, sipas procedurave ligjore në fuqi.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 453 par.1 të KPP-së.

- Sa i përket kërkesës pasurore-juridike, Gjykata në kuptim të nenit 462 par.3 të KPP-së palën e dëmtuar e ka udhëzuar në kontest të rregullt civil.

- Për arsyet e lartcekura, e në kuptim të nenit 357 par.1, nënpar.1.3 lidhur me nenin 158 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.78/2005, me datë 03.05.2024.

Kryetari i Trupit Gjykses,

Fatos Sejdiqaj

- **KËSHILLË JURIDIKE** : Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa e personave të autorizuar në afatin prej tre (3) ditësh nga pranimi i tij, nëpërmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.